



MBROJTJA E FËMIVE NGA KEQPËRDORUESIT E RRJETEVE SOCIALE

Motorët e internetit “Google”, “Facebook”, “Yahoo”, “Hotmail”, etj. e kanë dinamizuar jetën, kanë sjellur risi në komunikim, kreativitet, informim, transmetim të porosive, video-inçizimeve, filmave, etj. Ai ka sjellur risi edhe në mësim dhe dije të përgjithshme, e veçmas në komunikimet individuale, grupe dhe ato të ndjeshme nga miliarda njerëz të rruzullit tokësor. Në këtë mënyrë, jetës së njeriut i është dhënë qasje krejt më ndryshe nga e kaluara e njerëzimit. Sidoqoftë, komunikimet në këtë stad zhvillimesh në këto rrjete sociale, pa pajisje të përgjithshme, me përparësitë dhe pasojat për jetën e njeriut janë shumë të nevojshme dhe kjo përbën detyrën më me prioritet lidhur me pajisjen e fëmive dhe prindërve me informata se cilat janë rreziqet e përdorimit të pakontrolluar të këtyre faqeve sociale në botën bashkëkohëse.

I nderuar përdorues të internetit, para se të vendosni që të shtypni tastin e kompjuterit, duhet të dini se:

1. Kompjuteri është pajisje e sofistikuar me kapacitet shumë të madh, me mundësi të postimit dhe të pranimit të informatave të shumta.
2. Pranimi dhe postimi informatave mund të shkojë dhe të vijë në rrugë të gabuara.
3. Nëse ke vendosur një informatë në kompjuter të lidhur me rrjet, ajo mund të regjistrohet në një server, ku mund të qëndrojë me vjet të tërë pa dëshirën tënde.
4. Rrjetet sociale të lidhura për përdorim lodrash të dedikuara për fëmijë dhe komunikimi i pakontrolluar përbëjnë rrezikun më të madh për vet të ardhmen e këtyre fëmive. Privatësia e tyre e postuar në moshën e adoleshencës në internet, pa vetëdije, përbën ankthin dhe brengën në moshat e pjekura për këta fëmijë.
5. Nuk duhet cenuar privatësinë personale të komunikuesit që nuk e njeh dhe nuk duhet pranuar mesazhe të kësaj natyre.
6. Kujdesu që fjalëkalimin tënd ta kesh vetëm për vete dhe mos lejo që ta përdorin të tjerët, përveç prindërve tu.
7. Ata që nuk i njeh, mos u jep informata personale të profilit tënd, sepse mund të keqpërdoren.

Të nderuar fëmijë dhe prindër, për shqetësimet e juaja në rast se keni konstatuar shkelje të privatësisë suaj apo abuzim me të dhënat e juaja personale, ju këshillojmë që të kontaktoni Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale që t'ju vijë në ndihmë.

INTERNETI

I - Informohu mirë se kush është personi me të cilin komunikon!

N - Ndaj me komunikuesin vetëm informacionet që mund ti thuash drejtpërdrejt dhe fizikisht para tij!

T - Temat e komunikimit të jenë të përgjithshme!

E - Emërtimi i fjalëkalimit të ketë kombinim të shkronjave dhe numrave dhe të ketë mbi 12 shenja (numra dhe fjalë), sa më shumë aq më mirë!

R - Ruaju dhe shmang kërkesat për miqësi të personave që nuk i njeh!

N - Ndrej parametrat tua të sigurisë, rregullo profilin tënd!

E - E di që cenimi i privatësisë së tjetrit është vepër penale dhe e dënushme me ligj!

T - Takimet tua mund të organizohen edhe jashtë internetit dhe faqeve “virtuale”. Jeta është e bukur edhe jashtë internetit. Jeto atë!

I - Interesimi yt për ndarjen e informatave të ndjeshme, së pari të adresohet te prindërit tu. Shkeljet dhe abuzimet mund ti raportosh në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale!